



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORI

Departamenti i **Infermieristikës** në *Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike*, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për nevojat e tij shpall për zhvillimin e procesit mësimor konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023.

**Kriteret e përgjithshme e të veçanta** për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme** për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave apo ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në *Shkenca Mjekësore/Infermieristike*, profili mjekësi e përgjithshme / infermieri e përgjithshme/ infermier mami etj me notë mesatare mbi 8.5. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Të ketë përvojë në fushën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor.
3. Të ketë kryer kurse kualifikimi brenda ose jashtë vendit në fushën e Shkencave Mjekësore.
4. Preferohet të ketë përvojë akademike dhe botime në revista shkencore.
5. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
6. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim në Fakultetin i Shkencave Mjekësore Teknike  
Departamenti i Infermieristikës  
Elbasan**